

Strategjitë gjithëpërfshirëse të Qeverisë: niveli i zbatimit, sfidat dhe impakti në nxjerrjen e politikave



Strategjitë gjithëpërfshirëse të Qeverisë: niveli i zbatimit, sfidat dhe impakti në nxjerrjen e politikave



Përgatitur nga: Besnik Prekazi

E drejta e autorit © 2019. Democracy Plus (D+)

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, ruhet apo transmetohet në çfarëdo forme apo përmes çfarëdo mjeti elektronik, mekanik, fotokopjohet apo të tjera, pa lejen e D+.

Përkrahur nga:



"Ky projekt u financua përmes grantit të Ambasadës Amerikane në Prishtinë. Mendimet, përfundimet dhe konkludimet apo rekomandimet e shprehura këtu janë të Autorit(ëve) dhe jo medoemos pasqyrojnë qëndrimet e Departamentit të Shtetit."

PËRMBAJTJA

Lista e shkurtesave	4
Hyrje	5
Metodologjia	6
Niveli i implementimit të pesë strategjive	7
1. Strategjia Kombëtare për Zhvillim (2016-2021)	8
- Progresi i realizimit të strategjisë	8
- Sfidat dhe pengesat në implementim të strategjisë	9
- Impakti i strategjisë në nxjerrjen e politikave	10
2. Strategjia për Përmirësimin e Planifikimit dhe Koordinimit të Politikave në Kosovë (Sistemi i Planifikimit të Integruar) (2017-2021)	10
- Përmbushja e Planit të Veprimit	11
- Sfidat dhe pengesat në implementim të strategjisë	12
- Impakti i strategjisë në nxjerrjen e politikave	12
3. Strategjia për Modernizmin e Administratës Publike (2015-2020)	12
- Përmbushja e Planit të Veprimit	12
- Sfidat dhe pengesat në implementim të strategjisë	14
- Impakti i strategjisë në nxjerrjen e politikave	14
4. Strategjia për Vetëqeverisje Lokale (2016-2026)	15
- Përmbushja e Planit të Veprimit	15
- Sfidat dhe pengesat në implementim të strategjisë	16
- Impakti i strategjisë në nxjerrjen e politikave	16
5. Strategjia për Trajnim të Nëpunësve Civilë (2016-2020)	17
- Përmbushja e Planit të Veprimit	17
- Sfidat dhe pengesat në implementim të strategjisë	18
- Impakti i strategjisë në nxjerrjen e politikave	18
Rekomandime	19

LISTA E SHKURTESAVE

ARE	Agjenda e Reformave Europiane
BE	Bashkimit Evropian
DMRAP	Departamenti për Menaxhimin e Reformës së Administratës Publike
IKAP	Instituti i Kosovës për Administratë Publike
KASH	Korniza Afatmesme e Shpenzimeve
MAP	Ministria e Administratës Publike
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
PRE	Programit të Reformës Ekonomike
PKZMSA	Plani Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit
SKZH	Strategjia Kombëtare për Zhvillim
SMAP	Strategjia për Modernizmin e Administratës Publike
SMIL	Sistemit të Menaxhimit dhe Informacionit të Lëndëve
SVL	Strategjia për Vetëqeverisje Lokale
STNC	Strategjia për Trajnim të Nëpunësve Civilë
SPI	Sistemi i Planifikimit të Integruar
SRMFP	Strategjia për Reformën e Menaxhimit të Financave Publike
SPPKP	Strategjia për Përmirësimin e Planifikimit dhe Koordinimit të Politikave në Kosovë
SRrM	Strategjia për Rregullim më të Mirë 2.0 për Kosovën 2017-2021
ZKM	Zyra e Kryeministrit
ZPS	Zyra për Planifikim Strategjik

HYRJE

Dokumente me rëndësi, të cilat kanë për qëllim avancimin e procesit të përafrimit të legjislacionit të Kosovës me atë të Bashkimit Evropian (BE) janë: Plani Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (PKZMSA) dhe Agjenda e Reformave Europiane (ARE) dhe Reformave Ekonomike dhe Planifikimeve Buxhetore me anë të Programit të Reformës Ekonomike (PRE) dhe Korniza Afatmesme e Shpenzimeve (KASH).

Ndërsa prioritetet e saj afatëgjate në fushën e reformës së administratës publike Qeveria e Kosovës i përcakton me anë të kornizës strategjike gjithëpërfshirëse e cila përbëhet nga katër (4) dokumente bazë: 1) Strategjia për Modernizimin e Administratës Publike 2015-2020 (SMAP); 2) Strategjia për Reformën e Menaxhimit të Financave Publike 2016-2020 (SRMFP) 3) Strategjia për Përmirësimin e Planifikimit dhe Koordinimit të Politikave në Kosovë (SPPKP) dhe 4) Strategjia për Rregullim më të Mirë 2.0 për Kosovën 2017-2021 (SRrM).

Megjithatë për fusha specifike dhe politika sektoriale hartohen dokumente strategjike sektoriale, të cilat kanë për qëllim, përmirësimin apo reformimin e një sektori apo politike. D+ ka zgjedhur të analizojë pesë dokumente të tilla dhe me anë të këtij hulumtimi vlerëson nivelin e zbatimit të tyre, në nivel të aktiviteteve, nëse janë përmbushur ato në afatet kohore të përcaktuara në Planet respektive të Veprimit. Këto pesë strategji janë të natyrës multisektoriale dhe njësektoriale, ku bartëse të tyre janë institucione të ndryshme. Ndërsa e përbashkëta e tyre është se të gjitha janë gjithëpërfshirëse dhe kanë për qëllim reformimin e administratës publike në tërësi.

Dokumentet strategjike përcaktojnë prioritetet dhe drejtimin për politikën publike që ndiqen nga institucionet bartëse dhe ato të linjës, dhe si të tilla i japin drejtim politikave madhore. Prandaj është tejet e rëndësishme të bëhet matja e nivelit të zbatimit të tyre. Kjo do t'i ndihmonte Qeverisë të bëjë vlerësimin e prioriteve aktuale dhe të atyre që duhet t'i caktojë për të ardhmen, qoftë në lidhje me reforma administrative, ekonomike apo edhe në procesin e integritetit në BE.

Bartëse të dy nga pesë strategjitë e përzgjedhura, është Zyra për Planifikim Strategjik (ZPS) në kuadër të Zyrës së Kryeministrit (ZKM): 1) Strategjia Kombëtare për Zhvillim (SKZH) dhe 2) Strategjia për Përmirësimin e Planifikimit dhe Koordinimit të Politikave në Kosovë (SPPKP). Dy të tjerat, 1) Strategjia për Modernizimin e Administratës Publike 2015-2020 (SMAP) dhe 2) Strategjia për Trajnimin e Nëpunësve Civil barten nga Ministria e Administratës Publike (MAP), ndërsa Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) është bartëse e Strategjisë për Vetëqeverisje Lokale.

Ky hulumtim është i ndarë në pesë seksione dhe secili seksion e trajton një strategji në tri aspekte:

- **Përmbushja e Planeve të Veprimit, në nivel të aktiviteteve;**
- **Sfidat dhe pengesat në implementim të strategjisë; dhe**
- **Ndikimi i strategjisë në prodhimin e politikave apo vendimeve të reja.**

METODOLOGJIA

Këto pesë strategji janë përzgjedhur për t'u analizuar niveli i zbatimit të tyre pasi që janë para të përmbylljes apo kanë përmbyllur Planin e parë të Veprimit. Për vlerësimin e nivelit të implementimit të pesë strategjive të përzgjedhura për këtë hulumtim është bërë kombinimi i metodave, humlumtim nga zyra dhe intervista. Ky hulumtim i vlerëson pesë strategjitë në tri aspekte a) përbushja e planeve të veprimit në nivel të aktiviteteve; b) sfidat dhe pengesat në implementim të strategjisë; dhe c) impakti i strategjisë në prodhimin e politikave apo vendimeve të reja.

Në fazën e parë është analizuar aspekti i përbushjes së Planeve të Veprimit të pesë strategjive, në nivel të aktiviteteve. Janë selektuar aktivitetet për secilin objektiv për të cilat afati kohor i zbatimit është paraparë që të përmbyllet deri në fund të 2018. Nga këto Plane të Veprimit janë dizajnuar tabela të cilat u janë dërguar institucioneve për t'i plotësuar me të dhëna nëse janë përfunduar apo jo aktivitetet e parapara me Plan të Veprimit për vitet 2015, 2016, 2017 dhe 2018. Në këtë mënyrë janë nxjerrur të dhëna kuantitative, të cilat paraqesin progresin apo ngecjen e zbatimit të dokumenteve strategjike.

Në këtë fazë, të dhënat janë marrë përmes dy formave: nga raportet gjashtëmujore dhe vjetore dhe tabelave të dërguara nga

D+ te institucionet bartëse të cilat u plotësuan nga ana tyre. Departamenti për Menaxhimin e Reformës së Administratës Publike (DMRAP) në Ministrinë e Administratës Publike (MAP) ka insistuar që D+ të bëjë vlerësimin e implementimit të SMAP bazuar vetëm në raportet gjashtëmujore dhe vjetore që ky institucion harton në baza të rregullta. Këto raporte janë shfrytëzuar në pjesën analitike, mirëpo për t'i plotësuar tabelat me të dhëna sipas metodologjisë, D+ ka kontaktuar departamente tjera në këtë ministri, si Departamenti i Administrimit të Shërbimit Civil, Departamenti Ligjor dhe Zyrën e Kryeministrit, të cilat kanë ofruar këto të dhëna.

ZPS është bartëse e dy strategjive të cilat D+ i ka analizuar në këtë hulumtim. Për shkak të strukturës së Strategjisë Kombëtare për Zhvillim 2016-2021 (SKZH) (shih faqe 7) e cila nuk ka Plan të Veprimit, D+ ka përdorur një raport të dërguar nga ZPS. Në këtë raport është përdorur një metodologji e përafërt me atë të D+, për matjen e nivelit të implementimit të strategjisë. Ndërsa për Strategjinë për Përmirësimin e Planifikimit dhe Koordinimit të Politikave në Kosovë 2017-2021 ZPS, ka plotësuar tabelën e D+.

Institucioni/Strategjia	Faza I		Faza II	
	Tabela e dizajnuar nga D+	Raporte gjashtëmujore/vjetore	Intervista	Raporte gjashtëmujore/vjetore
ZPS/SKZH		✓	✓	✓
ZPS/ SPI	✓		✓	
MAPL/ SVL	✓		✓	
MAP/SMAP		✓		✓
MAP/STNC	✓		✓	✓

Normalisht, zbatimi i akviteve dhe strategjisë në përgjithësi nuk është një dimensional dhe i shkëputur nga konteksti dhe rrethanat. Andaj për të nxjerrë një pasqyrë më të qartë të zbatimit të strategjisë, në fazën e dytë, janë realizuar intervista me zyrtarë përgjegjës për vlerësim dhe monitorim të implementimit të strategjisë. Intervistat kanë pasur për qëllim të identifikojnë dy aspekte të tjera: a) sfidat dhe pengesat në implementim të strategjisë dhe b) ndikimin e strategjisë në prodhimin e politikave apo vendimeve të reja.

NIVELI I IMPLEMENTIMIT TË PESË STRATEGJIVE

Niveli i implementimit të një strategjie duhet të jetë i matshëm dhe të vlerësohet në baza të rregullta dhe periodike. Raportimi i rregullt mbi nivelin e zbatimit të një dokumenti strategjik i shërben si institucioneve përgjegjëse, ashtu edhe atyre të linjës që të bëjnë planifikimet e tyre afatshkurtëra dhe afatgjata, me qëllim të arritjes së reformave ekonomike, administrative dhe ligjore. Vlerësimi i zbatimit të dokumenteve strategjike gjithashtu është i nevojshëm për të vërtetuar nevojën për hartim të dokumenteve të reja strategjike, rishikim të atyre aktuale dhe shëben si bazë për draftimin e strategjive pasuese.

Rezultatet e hulumtimit të D+, "Politikëbërja në nivel nacional 2012-2017" tregojnë se një numër mjaft i vogël i institucioneve bartëse të strategjive bëjnë vlerësimin e nivelit të implementimit të tyre. Nga 16 ministri dhe pesë (5) zyra në kuadër të Zyrës së Kryeministrit (ZKM), të

cilat D+ i ka analizuar në këtë hulumtim, vetëm gjashtë (6) ministri dhe tri (3) zyra në ZKM kanë dëshmuar se bëjnë monitorim dhe vlerësim të zbatimit të strategjive¹. Megjithatë, këto gjashtë (6) ministri kanë më shumë se një dokument strategjik, dhe monitorimi dhe vlerësimi nuk ju bëhet të gjithave, por vetëm njëres ose disave prej tyre. Ndërsa tre (3) nga pesë (5) zyrat në kuadër të ZKM bëjnë vlerësimin e implementimit për të gjitha strategjitë e tyre.

Në këtë hulumtim, D+ është fokusuar në analizimin e pesë dokumenteve strategjike gjithëpërfshirëse, me qëllim që të bëhet një vlerësim i nivelit të zbatimit të tyre. Kjo metodë do t'ju shërbente të gjitha institucioneve hartuese të dokumentëve strategjike si model për matjen e implementimit, veprim ky që tashmë është i detyrueshëm me Udhëzimin e ri Administrativ 07/2018². Po ashtu, në mënyrë të thejshtëzuar, mënyra e matjes së implementimit të strategjive është përshkruar në aneks dokumentin "Manual për planifikimin, hartimin dhe monitorimin e dokumenteve strategjike dhe planeve të tyre të veprimit"³.

Më poshtë janë paraqitur gjetjet në lidhje me nivelin e zbatimit, sfidat dhe pengesat në implementim, si dhe impakti i pesë strategjive të përzgjedhura nga D+.

¹ Osmani, Roberta & Prekazi, Besnik. (2018). Politikëbërja në nivel nacional, Democracy Plus, Prishtinë, në: <https://bit.ly/2QfiDC8>

² Udhëzim Administrativ (QRK) nr. 07/2018 për planifikimin dhe hartimin e dokumenteve strategjike dhe planeve të veprimit: neni 16, në: <https://bit.ly/2D00yUU> F. 24

³ Manuali për planifikimin, hartimin dhe monitorimin e dokumentëve strategjike dhe planëve të tyre të veprimit, në: <https://bit.ly/2D44bUT> f. 41

1. Strategjia Kombëtare për Zhvillim (2016-2021)

Zyra për Planifikim Strategjik ka përgjegjësi të asistojë të gjitha institucionet gjatë hartimit të dokumenteve të reja strategjike dhe të përkujdeset që prioritetet qeveritare të pasqyrohen në këto dokumente dhe ndërliken me dokumente tjera të qeverisë. Përveç kësaj ajo harton strategji kombëtare për të cilat është edhe bartëse kryesore. Në vitin 2016 Qeveria e Kosovës ka aprovuar Strategjinë Kombëtare për Zhvillim 2016-2021 (SKZH) e cila dallon shumë nga strategjitë sektoriale, pasi që përcakton politika madhore shtetërore dhe listën e prioritetëve të larta kombëtare për zhvillim ekonomik dhe përmirësim të standardeve jetësore⁴.

SKZH është një dokument që ka për synim t'i adresojë pengesat kryesore për zhvillim të Kosovës dhe ndahet në katër shtylla: a) kapitali njerëzor; b) qeverisja e mirë dhe sundimi i ligjit; c) industria konkurruese; dhe d) infrastruktura. Për qëllime të këtij hulumtimi, D+ fokusohet vetëm në shtyllën e dytë "qeverisja e mirë dhe sundimi i ligjit". Aspektet që SKZH synon t'i përmirësojë në lidhje me qeverisjen e mirë dhe sundimin e ligjit janë drejtësia dhe paanshmëria e institucioneve, si dhe efektiviteti i tyre në kryerjen e shërbimeve. Më konkretisht, të ulë koston financiare dhe të shkurtojë pritjet e gjata kohore për qytetarët dhe bizneset në procese administrative.

Progresi i realizimit të strategjisë

SKZH, është një dokument strategjik multisektorial, i cili dallon nga strategjitë tjera edhe për mënyrën se si është organizuar. Ky dokument nuk i përmbahet strukturës për hartim të dokumenteve stragjike të përcaktuar me Udhëzimin Administrativ 02/2012, veçanërisht në lidhje me Planin e Veprimit. Pra, SKZH nuk ka Plan të Veprimit, mirëpo ka të hartuar "Udhërrëfyesin për Zbatimin e Strategjisë", i cili është aprovuar në prill të vitit 2017. Për këtë arsye, D+ nuk ka mundur të përdorë metodologjinë e njëjtë sikur të strategjitë tjera të analizuar në këtë hulumtim për të matur zbatimin e strategjisë bazuar në aktivitetet e parapara dhe afatet e caktuara për zbatim të tyre me Plan të Veprimit. Megjithatë, ZPS drafton raporte vjetore me anë të të cilëve mat nivelin e implementimit të strategjisë në katër (4) shtyllat, ku në vitin 2018 ka nxjerrur raportin e parë të vlerësimit të implementimit të strategjisë, për dy vitet e para të implementimit. Këtë raport D+ e ka përdorur për të analizuar nivelin e zbatimit të strategjisë.

Sipas këtij raporti, SKZH karakterizohet nga një numër i madh masash dhe aktiviteteve që do të zbatohen në një periudhë pesë vjeçare.

Tabela 1. Organizimi i SKZH

Shtylla	Masa	Aktivitete	Afati i zbatimit
4	34	135	2017-2019

Burimi: Raporti i parë i ZPS për vlerësimin e implementimit të SKZH

⁴ Strategjinë Kombëtare për Zhvillim 2016-2021, në: <https://bit.ly/2iB1i3S>


Në kuadër të shtyllës së dytë “qeverisje e mirë dhe sundimi i ligjit” SKZH ka gjithsej tetë (8) masa. Në raportin e vlerësimit të implementimit të strategjisë, ZPS tregon në përqindje dhe në faza nivelin e zbatimit të këtyre masave. Për tetë masa të shtyllës së dytë janë paraparë gjithsej 32 aktivitete. Figura më poshtë, e cila është përpunuar nga ZPS dhe e cila mat progresin e zbatimit të strategjisë, tregon se shumica dërrmuese apo 62% e masave të parapara nën shtyllën e dytë kanë filluar zbatimin, 23% prej tyre janë në një nivel të avancuar të zbatimit, 8% nuk kanë filluar të zbatohen dhe vetëm 8% janë zbatuar.

Në disa nga masat në shtyllën “qeverisja e mirë dhe sundimi i ligjit”, ku një numër i aktiviteteve nuk kanë arritur ndonjë progres gjatë kohës kur ZPS ka raportuar, ndërlidhen me çështje që kanë të bëjnë me zvogëlimin e pengesave administrative, efikasitetin në sistemin e inspektimit, vendimmarrjen e bazuar në të dhëna, prokurimin publik dhe forcimin e sistemit të të drejtave pronësore.

Sfidat dhe pengesat në implementim të strategjisë

Disa nga ministritë bartëse të zbatimit të masave të parapara me SKZH, sipas raportit të ZPS, janë vonuar në fillimin e zbatimit të aktiviteteve, duke ndikuar pastaj në mospërmbyshjen e 15 masave në afatin e paraparë kohor. Implementimin e suksesshëm të kësaj strategjie do ta mundësonte integrimi i aktiviteteve dhe nën-aktiviteve në Planin e Veprimit të Punës së Qeverisë (PVPQ). ZPS ka provuar t’a bëjë këtë gjë, mirëpo ka hasur në mospërputhje mes aktiviteteve të PVPQ dhe SKZH, sfidë e cila do të mbetet edhe për vitet e ardhshme. Gjithashtu, sfidë me rëndësi mbetet edhe marrëveshja mes ZPS dhe ministrive bartëse të masave të SKZH për mbledhjen e të dhënave dhe raportimin mbi nivelin e zbatimit të strategjisë. Sipas raportit të ZPS, ministritë nuk duhet t’i mbajnë informacionet në lidhje me zbatimin e objektivave të PVPQ që lidhen me aktivitetet dhe nënaktivitetet e SKZH. Realizimi i aktiviteteve të kësaj strategjie vështirësohet gjithashtu edhe nga mënyra se si planifikohet buxheti i Kosovës, i cili sipas raportit të ZPS-së, prioretizon institucionet dhe jo politikat.

Figura 1. Shkalla e zbatimit të aktiviteteve



Burimi: Raporti i parë për implementimin e SKZH

Impakti i strategjisë në nxjerrjen e politikave

Raporti i ZPS tregon se SKZH ka pasur ndikim të drejtpërdrejtë në reformim të institucioneve në katër shtyllat përbërëse të strategjisë. Sa i përket shtyllës së dytë "qeverisja e mirë dhe sundimi i ligjit", ZPS numëron si suksese rritjen e efikasitetit në gjyqësor dhe prokurim publik, ku janë krijuar procedura që do të zvogëlojnë ngarkesat administrative për qytetarët dhe bizneset⁵. Gjithashtu, progres konsiderohet se është arritur edhe te inspektimet tatimore dhe doganore, por ka pasur vonesa në përgatitjen e legjislacionit për një sistem të unifikuar të inspektimeve. Suksesi më i madh mund të konsiderohet, fillimi i zbatimit të Sistemit të Menaxhimit dhe Informacionit të Lëndëve (SMIL), i cili ka për synim të rrisë transparencën, efikasitetin dhe llogaridhënien në ofrimin e shërbimeve nga ana e gjyqësorit dhe sistemit prokurorial të Kosovës⁶.

2. Strategjia për Përmirësimin e Planifikimit dhe Koordinimit të Politikave në Kosovë (Sistemi i Planifikimit të Integruar) (2017-2021)

Sistemi i bërjes së politikave në Kosovë është mjaft i fragmentuar dhe karakterizohet nga një numër relativisht i madh i ministrive dhe agjensioneve të pavarura të cilat hartojnë politika të nivelit nacional. Andaj, koordinimi i gjithë gamës së institucioneve politikëbërëse, në mënyrë që ato të mos jenë të shkëputura nga njëra-tjetra dhe të jenë të planifikuara mirë është çështje kruciale.

Zyra për Planifikim Strategjik në vitin 2016 ka hartuar Strategjinë për Përmirësimin e Planifikimit dhe Koordinimit të Politikave në Kosovë (Sistemi i Planifikimit të Integruar) 2017-2021⁷ (SPI). Ky dokument strategjik ka për synim t'i rregullojë raportet mes institucioneve financiare dhe administrative, të cilat kanë rol kyç në koordinimin dhe në kapërcimin e fragmentimit dhe dyfishimit në sistemin e planifikimit të politikave në nivel qendror⁸. Implementimi i kësaj strategjie në plotëni do t'i kontribuonte politikëbërjes nacionale në nxjerrjen e politikave në mënyrë më efikase dhe më mirë të koordinuara.

Tabela 2. Struktura e Planit të Veprimit të SPI

Objektiva të përgjithshëm	Objektiva specifike	Aktivitete	Afati i zbatimit
4	11	42	2017-2019

Burimi: Plani i Veprimit, SPI

⁵ Raporti i parë për zbatimin dhe rezultatet e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim 2016-2021

⁶ Intervistë: Venhar Nushi, Zyrtar i Lartë për Planifikim të Politikave në ZPS. Datë 21.01.2019

⁷ Strategjinë për Përmirësimin e Planifikimit dhe Koordinimit të Politikave në Kosovë (Sistemi i Planifikimit të Integruar) 2017-2021, në: <https://bit.ly/2sZlYqL>

⁸ Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2012 Për procedurat, kriteret dhe metodologjinë e përgaditjes dhe miratimit të dokumenteve strategjike dhe planeve për zbatimin e tyre, në <https://bit.ly/2BebSb8>

Përmbythja e Planit të Veprimit

Plani i Veprimit 2017-2019 i SPI është hartuar bashkë me strategjinë dhe i përmbahet të gjitha kriterëve për hartim të dokumenteve strategjike të Udhëzimit Administriv 02/2012⁸. Për dallim nga strategjitë tjera, Plani i Veprimit të SPI është shumë specifik dhe synon t'i rregullojë disa fusha me rëndësi në koordinimin dhe planifikimin e politikave, si përmirësimin e kornizës së planifikimit strategjik; përmirësimin e ndërlidhjes së dokumenteve strategjike dhe burimeve financiare dhe integrimin e praktikave dhe proceseve të monitorimit.

Periodha kohore në të cilën koncentrohet ky hulumtim përfshin vitet nga koha kur dokumenti strategjik ka hyrë në fuqi deri në fund të dhjetorit të vitit 2018, kur edhe hulumtimi është zhvilluar. Për këtë qëllim, për t'u analizuar janë marrë vetëm aktivitetet, afati i zbatimit të të cilëve bie në këto vite. Ndërsa aktivitetet që janë planifikuar të zbatohen në apo gjatë vitit 2019 janë lënë jashtë fokusit të këtij hulumtimi. Dy (2) nga 42 aktivitete janë planifikuar të implementohen në vitin 2019, ndërsa nga 40 të tilla që janë

planifikuar të zbatohen në vitet 2017-2018, 29 prej tyre janë realizuar suksesshëm, ndërkaq 11 tjera nuk janë realizuar fare.

Megjithëse janë realizuar shumica e aktiviteteve, prej atyre që nuk kanë arritur të plotësohen apo pritët të plotësohen në vitet në vijim ka të tilla me një rëndësi të veçantë dhe impakt në procese dhe dokumente të tjera me rëndësi. Aktiviteti katër "Sigurimi i ndërlidhjes së ARE me SKZH, PRE, PKZMSA" i cili bie nën objektivin specifik "Përmirësimi i planifikimit strategjik të politikave për përmbythjen e detyrimeve të MSA" nuk është realizuar, mirëpo sikur të realizohej, do të zhblllokonte implementimin e shumë aktiviteteve tjera të kësaj strategjie dhe strategjive të tjera aktive të qeverisë. Tjetër aktivitet me rëndësi, sidomos në lidhje me monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të strategjive, i cili nuk ka arritur të realizohet është "Krijimi i grupit për menaxhim strategjik (GMS) në secilën ministri, i cili do të kryesohet nga ministri". Zbatimi i këtij aktiviteti do të rregullonte një ndër problemet kyçe të raportimit mbi zbatimin e strategjive.

Figura. 2 Zbatimi i Aktiviteteve të Planit të Veprimit 2017-2019



Sfidat dhe pengesat në implementim të strategjisë

Realizimi i kësaj strategjie nuk ka hasur në shumë pengesa, pasi që për shumicën dërrmuese të aktiviteteve, bartëse të implementimit është ZKM me zyrat e saj, por kryesisht ZPS. Për pjesën tjetër të aktiviteteve, bartës janë një numër i vogël i institucioneve kryesisht Ministria e Financave dhe ajo e Integritetit Evropian, gjë që mundëson implementim më të lehtë të kësaj strategjie. Sfidë dhe pengesë e vetme mbetet ndërrimi i qeverive, rrjedhimisht i prioritetëve të qeverisë. Me ardhjen në pushtet të kabinetit të ri qeverisës, i cili nuk është hartues i dokumentit strategjik në fuqi, vështirësohet harmonizimi i prioritetëve të qeverisë dhe synimeve të këtij dokumenti⁹.

Impakti i strategjisë në nxjerrjen e politikave

SPI karakterizohet nga një numër i madh i aktiviteteve të realizuara nga Plan i parë i Veprimit. Nga këto aktivitetet të përmbushura, ndikimi i strategjisë shtrihet në dy fusha me rëndësi, në koordinim dhe planifikim më të mirë të politikave. E para, si rezultat i kësaj strategjie, është arritur që të organizohen trajnime në ngritje të cilësisë së tyre për stafin e ministrive dhe institucioneve tjera që hartojnë dokumente strategjike. Dhe së dyti, SPI ka ndikuar që të përmirësojë dhe strukturojë kornizën strategjike të qeverisë, duke e bërë atë më të unifikuar dhe më të standardizuar, gjë që do të mundësojë defraktizimin e koordinimit dhe planifikimit të politikave.

3. Strategjia për Modernizimin e Administratës Publike (2015-2020)

Dokumentit strategjik i MAP, Strategjia për Modernizimin e Administratës Publike (SMAP) i cili do të implementohet në një periudhë pesë vjeçare 2015-2020, ka për qëllim reformimin e administratës publike të Kosovës në tri shtylla. Përmes saj, synohet t'ju hapet rruga implementimit më të lehtë dhe më të suksesshëm politikave madhore qeveritare, që kanë të bëjnë me zhvillim ekonomik dhe ofrimin e shërbimeve publike administrative për qytetarët dhe bizneset¹⁰.

Plani i Veprimit 2015-2017 i SMAP i respekton të gjitha kriteret për hartim të dokumenteve të përcaktuar me UA 02/2012, dhe për arsye të implementimit më të lehtë, i njëjti është i ndarë në tri shtylla: a) Shërbimi civil; b) Procedurat administrative dhe ofrimi i shërbimeve publike administrative; dhe c) Organizimi i administratës publike dhe llogaridhënia.

Përmbushja e Planit të Veprimit

Për dokumentin strategjik SMAP, MAP ka hartuar dy plane të veprimit: Planin e Veprimit 2015-2017, i cili ka skaduar tashmë dhe Planin e Veprimit 2018-2020 i cili është në implementim e sipër. D+ i ka analizuar të dy planet, mirëpo për analizë të nivelit të zbatimit ka marrë për bazë vetëm të parin. Plan i Veprimit të SMAP është njëri prej planeve më voluminoze dhe komplekse për shkak se synon të avancojë Administratën Publike të Kosovës në tërësi.

Tabela 3. Struktura e Planit të Veprimit të SMAP

Objektiva të përgjithshëm	Objektiva specifike	Aktivitetet	Afati i zbatimit
3	15	54	2015-2017

Burimi: Plani i Veprimit SMAP

¹⁰ Strategjia për Modernizimin e Administratës Publike 2015-2020, në: <https://bit.ly/2g9yuwb>


Shtylla I “Shërbimi Civil” përbëhet nga gjithsej 18 aktivitete, të parapara të realizohen gjatë viteve 2015-2017. Nga të dhënat e ofruara nga MAP (të paraqitura në figurën 4) shihet që në këtë shtyllë shumica dërrmuese e aktiveve, 15 sosh janë realizuar, ndërsa vetëm tri (3) të tjera nuk janë realizuar dhe tashmë janë përfshirë në Strategjinë për Trajnimin e Nëpunësve Civil dhe pritet të realizohen me këtë strategji.

Shtylla II “Procedurat Administrative dhe Ofrimi i Shërbimeve Publike Administrative” përmban më së shumti aktivitete krahasuar me dy shtyllat tjera,

me gjithsej 25 aktivitete. 13 prej tyre janë realizuar, ndërsa 12 nuk janë realizuar. 12 aktivitetet që nuk janë realizuar nën këtë shtyllë, megjithëse shtrihen në objektiva strategjik dhe objektiva specifik të ndryshëm kanë një të përbashkët, digjitalizimin e administratës publike. Krijimi i one stop shop-ve për ofrim të shërbimeve për qytetarë, integrimi i sistemeve elektronike dhe interoperabiliteti janë disa nga veprimet që nuk janë realizuar në kuadër të këtyre 12 aktiviteteve.

Në fund, në shtyllën III “Organizimi i Administratës Publike dhe Llogaridhënia” janë caktuar më së paku aktivitete, gjithsej 11, dhe tetë (8) prej tyre janë realizuar.

Figura 3. Zbatimi i Aktiviteteve nën tre shtyllat e Planit të Veprimit 2015-2018



Burimi: Të dhëna të ofruara nga: ZKM, DASHC, DL/MAP

Sfidat dhe pengesat në implementim të strategjisë

Bazuar në raportet gjashtëmujore dhe vjetore me anë të të cilave MAP bënë vlerësimin e implementimit të strategjisë, sfidat kryesore në zbatimin e aktiviteteve dhe realizimin e indikatorëve, të cilat përsëriten pothuajse çdo vit janë:

- a) Financiare;**
- b) Vonesat në miratimin e legjislacionit;**
- c) Zbatimi i reformave.**

Ndryshimet e parapara me këtë strategji, sidomos në lidhje me sistemin e ri të pagave, përcillen me implikime financiare dhe mungesë të buxhetit. Nga viti 2015 deri në vitin 2018 nuk është arritur alokimi i fondeve të nevojshme nga buxheti i Republikës së Kosovës, duke shkaktuar ngecje në një varg reformash tjera të parapara me SMAP¹¹. Vonesat në miratim të ligjeve që dalin nga SMAP, përveç efekteve tjera ndikojnë edhe në zbatim të strategjisë dhe pengojnë realizimin e aktiviteteve pasuese apo të varura nga këto ligje. Dhe në fund, zbatimi i reformave të planifikuara me SMAP kërkon konsistencë në punën e institucioneve që preken nga këto reforma. Raporti i MAP paraqet me të drejtë si pengesë lëvizjet e zyrtarëve në departamente dhe pozita të ndryshme, për shembull ndërrimin e shpeshtë të stafit në një departament shumë të rëndësishëm, siç është Departamenti për Menaxhimin e Reformës së Administratës Publike (DMRAP).

Impakti i strategjisë në nxjerrjen e politikave

Meqë progresi më i madh në përmbushjen e aktiviteteve u bë në shtyllën e parë "Shërbimin civil" dhe të tretë "Organizimi i Administratës Publike dhe Llogaridhënia", edhe impakti i strategjisë ndërlidhet me këto dy fusha. Konkretisht, në shtyllën e parë është arritur të përmirësohet kualiteti i raportimit në lidhje me monitorimin e zbatimit të legjislacionit të shërbimit civil, zgjerimin e shtrirjes së sistemit elektronik të menaxhimit të burimeve njerëzore në të gjitha institucionet e Administratës Publike dhe krijimi i katalogut të vendeve të punës. Ndërsa në shtyllën e tretë, ndikimi më i madh, sidomos në aspektin e llogaridhënies, është hartimi dhe aprovimi nga ana e qeverisë të koncept-dokumentit për Qasje në Dokumente Publike.

¹¹ Raportet vjetore 2015, 2016, 2017 dhe 2018 Progresi i zbatimit të Strategjisë për Modernizimin e Administratës Publike 2015-2017

4. Strategjia për Vetëqeverisje Lokale (2016-2026)

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), si koordinatore dhe monitoruese e punës dhe veprimeve të komunave ka hartuar dokumentin strategjik Strategjia për Vetëqeverisje Lokale (2016-2026) më anë të së cilës mëton të vëndosë qytetarin në qendër, përballë detyrimeve të organeve lokale për shërbime komunale efikase dhe cilësore¹². Dokumenti strategjik i MAPL, Strategjia për Vetëqeverisje Lokale 2016-2026 është i destinuar të shërbejë si udhërrëfyes për komunat, në avancimin e vetëqeverisjes lokale.

Përmbushja e Planit të Veprimit

Afati kohor për implementim të Planit të Veprimit të Strategjisë për Vetëqeverisje Lokale 2016-2026 është 10 vite. Kjo e bën këtë Plan të Veprimit të dallojë nga planet tjera sepse është në kundërshtim me UA

02/2012 pasi që udhëzimi përcakton që Planet e Veprimit të mos jenë më të gjata se tri vite¹³. Megjithatë, ky hulumtim fokusohet dhe vlerëson vetëm aktivitetet, të cilëve koha për implementim ju bie në periudhën trivjeçare, nga viti 2016 deri në vitin 2018. Ky Plan i Veprimit përbëhet nga pesë objektiva të përgjithshëm, 11 objektiva specifik dhe gjithsej 74 aktivitete, mirëpo ky hulumtim fokusohet vetëm në 41 aktivitete për periudhën 2016-2018.


Nga të dhënat e ofruara nga MAPL, të paraqitura në tabelën më poshtë vërehet një nivel i ulët i implementimit të strategjisë, ku shumica e aktiviteteve të parapara për t'u realizuar brenda kësaj periudhe, nuk janë përmbushur, pra nga 41 aktivitete, janë realizuar vetëm 17. Të gjitha aktivitetet që janë realizuar kanë të bëjnë kryesisht me rregullime ligjore, menaxhuese dhe administrative.

Tabela 4. Struktura e Planit të Veprimit të Strategjisë për Vetëqeverisje Lokale 2016-2026

Objektiva të përgjithshëm	Objektiva specifik	Aktivitete	Afati i zbatimit
5	11	74	2016-2026

Burimi: Plani i Veprimit

Figura. 4 Zbatimi i Aktiviteteve të Planit të Veprimit 2016-2018



Burimi: të dhëna të ofruara nga MAPL

¹² Strategjia për Vetëqeverisje Lokale 2016-2026, në: <https://bit.ly/2DOHxBE>

¹³ Udhëzimi Administrativ nr. 02/2012 për procedurat, kriteret dhe metodologjinë e përgaditjes dhe miratimit të dokumenteve strategjike dhe planeve për zbatimin e tyre, në: <https://bit.ly/2UzTffr>

Ndërsa, aktivitetet të cilat nuk janë realizuar mbulojnë fusha të rëndësishme të vetëqeverisjes lokale dhe janë të shtrira në shumë objektiva strategjike dhe specifike. Zhvillimi ekonomik lokal është një aspekt, të cilin kjo strategji meton ta avancojë, por që fatkeqësisht asnjë nga aktivitetet e objektivit specifik “përkrahja e bizneseve dhe bujqësisë” nuk është zbatuar për vitet 2016-2018. Tjetër objektiv specifik shumë i rëndësishëm për qeverisjen lokale “pjesëmarrja efektive e qytetarëve në qeverisje” ka vetëm një aktivitet të realizuar. Dhe në fund, një aspekt që do t’i kontribuonte mjaft shumë qeverisjes lokale efektive, është përkrahja e shoqërisë civile dhe nxitja e vullnetarizmit qytetarë. Mirëpo, shumica e aktiviteteve të parapara nën objektivat strategjike dhe specifike që trajtojnë këto çështje nuk janë zbatuar.

Sfidat dhe pengesat në implementim të strategjisë

Ndër sfidat kryesore në zbatim të strategjisë janë zbatimi dhe raportimi mbi zbatim i aktiviteteve nga institucionet bartëse dhe të linjës. MAPL, si bartëse e strategjisë ka përmbushur të gjitha aktivitetet për të cilat ka qenë drejtpërdrejtë përgjegjëse për zbatim¹⁴. Ndërsa sa ju përket aktiviteteve për të cilat kanë qenë përgjegjëse ministrinë e linjës apo institucionet tjera, MAPL ka hasur në neglizhencë nga ana e të njëjtave për t’i zbatuar ato në tërësi. Gjithashtu, sfida mbetet edhe raportimi për zbatim të aktiviteteve nga institucionet bartëse, të cilat nuk raportojnë në baza të rregullta dhe periodike tek MAPL mbi fazën në të cilën gjenden me implementim të aktiviteteve. Dhe në fund, Plani i Veprimit të kësaj strategjie paraqet sfida po ashtu, pasi ka të planifikuara aktivitete për 10 vite dhe kjo e bën të vështirë rishikimin e tij dhe të strategjisë në tërësi.

Impakti i strategjisë në nxjerrjen e politikave

Një ndër sukseset më të mëdha të kësaj strategjie është hartimi dhe botimi i profilit të 38 komunave të Kosovës, i cili përmban informacione mbi demografinë, kapacitetet ekonomike dhe resurset natyrore, territorin dhe vendndodhjen gjeografike të të gjitha komunave. Poashtu, një arritje tjetër mund të konsiderohet edhe draftimi dhe aprovimi nga qeveria i koncept-dokumentit për Zhvillim Ekonomik Lokal, i cili e ka burimin nga Strategjia për Vetëqeverisje Lokale¹⁵.

¹⁴ Intervistë me Ferdi Kamberi, Departamenti për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave në MAPL, datë: 18 janarë 2019

¹⁵ Raporti: Zbatimi i Strategjisë për Vetëqeverisje Lokale: Periudha janar-dhjetor 2016, janar-dhjetor 2017 dhe janar-qershor 2018, në: <https://bit.ly/2TwbQ5L>

5. Strategjia për Trajnim të Nëpunësve Civilë (2016-2020)

MAP ka hartuar Strategjinë për Trajnim të Nëpunësve Civilë (2016-2020) e cila do të zbatohet në periudhën pesëvjeçare, dhe ka për qëllim avancimin dhe profesionalizimin e nëpunësve civil nëpërmjet ofrimit të trajnimeve të përhershme¹⁶. Në këtë mënyrë nëpunësit civil do të pajisen me shkathtësi të reja dhe adekuate, të cilat do të ndikojnë në përmirësimin e ofrimit të shërbimeve dhe në synimin e Kosovës për t'u afruar me shtetet e BE-së dhe integrimin në strukturat e saj. Gjithashtu, nënshkrimi i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit ndërmjet Kosovës dhe BE-së në vitin 2015 ka sjellur sfida të reja për administratën publike, të cilat kjo strategji ka për qëllim t'i adresojë.

Përbushja e Planit të Veprimit

Plan i Veprimit të Strategjisë për Trajnim të Nëpunësve Civilë (2016-2020) përmban gjithsej pesë objektiva të përgjithshme strategjike, me nga një ose dy objektiva

specifike, dhe me një numër relativisht të madh të aktiviteteve, të cilat janë paraparë të realizohen në mënyrë të përsëritur në një periudhë tri vjeçare.


Nga gjithsej 32 aktivitete të cilat janë planifikuar të realizohen në vitet 2016, 2017 dhe 2018, nga rezultati i analizës së D+ del që në vitin 2016, 25 prej tyre janë realizuar në afatin e paraparë, ndërsa shtatë (7) nuk janë përbushur. Në vitin 2017 dinamika e përbushjes së aktiviteteve ka pësuar rënje me 21 aktivitete të përbushura dhe 11 sosh të pa përbushura. Ndërsa për vitin 2018, MAP ende nuk e ka të përfunduar raportin e brendshëm, në lidhje me evidentimin e zbatimit të aktiviteteve të parapara për këtë vit. integrimit Evropian, me fokus në planifikim të politikave, përafrim ligjor, programim të asistencës, vlerësim dhe monitorim", dhe objektivin e përgjithshëm 4, objektivin specifik 1. "Trajnim në fushën e TI-së përmes programeve bazike".

Tabela 5. Numri total i objektivave të përgjithshëm, atyre specifik, numri i aktiviteteve dhe afati i zbatimit

Objektiva të përgjithshëm	Objektiva specifik	Aktivitete	Afati i zbatimit
5	7	32	2016-2018

Burimi: Plani i Veprimit të Strategjisë për Trajnim të Nëpunësve Civilë (2016-2020)

Figura 5 & 6 - Numri i aktiviteteve të zbatuara nga Plani i Veprimit për vitet 2016 dhe 2017



Burimi: Të dhëna të ofruara nga IKAP

¹⁶ Strategjinë për Trajnim të Nëpunësve Civilë 2016-2020, në: <https://bit.ly/2GghtkE>

Sfidat dhe pengesat në implementim të strategjisë

Instituti i Kosovës për Administratë Publike (IKAP), i cili është institucion qeveritar i themeluar për aftësimin e shërbyesëve civil është po ashtu përgjegjës për implementim të kësaj strategjie. Mungesa e mjeteve buxhetore të ndara për IKAP nga buxheti i qeverisë paraqet një sfidë vështirë të kapërcyeshme për implementimin e strategjisë. Ndërsa, sfida tjetër e rëndësishme në realizimin e kësaj strategjie është definimi i aktiviteteve në Plan të Veprimit dhe fakti se ai nuk i adreson nevojat për programe të trajnimit për nëpunës civil të identifikuar në strategji. Ky Plan sipas SIGMA-së ngjason më shumë me një plan të trajnimeve¹⁷. Pra, gjatë hartimit të tij nuk është definuar mjaftueshëm secili aktivitet gjë që e ka bërë të vështirë realizimin e tyre. IKAP është përpjekur të tejkalojë këtë pengesë duke draftuar katalogun e programeve të trajnimeve, ku janë listuar trajnimet e detajuara për nëpunës civil të administratës publike të Kosovës dhe janë ndërlidhur me Planin e Veprimit¹⁸.

Impakti i strategjisë në nxjerrjen e politikave

Ndikimi i Strategjisë për Trajnim të Nëpunësve Civilë (2016-2020) në administratën publike të Kosovës mund të matet nga të dhënat e IKAP përmes numrit të programeve trajnuese që nëpunësit civil kanë ndjekur dhe numrit të nëpunësve civil që kanë marrë pjesë në këto trajnime, e të cilat IKAP i ka dërguar D+. Në vitin e parë të realizimit të programeve trajnuese për nëpunës civil IKAP ka organizuar 81 programe dhe janë trajnuar 3.761 nëpunës civil. Në 2017, numri i programeve trajnuese ishte më i madh, gjithsej 86,

mirëpo numri i nëpunësve civil të cilët i kanë ndjekur këto trajnime ka rënë në 3.624.

Sipas raporteve vjetore të MAP për gjendjen në shërbim civil, në vitin 2016 numri i përgjithshëm i nëpunësve civil ka qenë 17.989¹⁹, ndërsa në vitin 2017 numri i nëpunësve civil ishte rritur dukshëm në 18.249²⁰. Megjithatë, raporti në mes të numrit të përgjithshëm të nëpunësve civil për vitet 2016 dhe 2017 dhe atyre që kanë ndjekur programe trajnuese, tregon se numër jo i kënaqshëm i nëpunësve civil (rreth 20%) i ndjekin programet e trajnimit që ofrohen nga IKAP. Rrjedhimisht, ndikimi i Strategjisë për Trajnim të Nëpunësve Civil 2016-2020 është jo i madh në ngritjen e cilësisë në shërbimet që ofron administrata publike. Megjithatë, është inicuar rekomandimi i SIGMA-së që të bëhet rregullimi i financimit të trajnimeve të nëpunësve përmes një norme dinamike bazuar në buxhetin e pagave të nëpunësve civil. Kjo normë nënkupton që nga buxheti i pagave të ndahet jo më pak se 1% e shumës për trajnime.

¹⁷ SIGMA/OECD. Kosovo Report, November 2017. Paris: OECD/SIGMA. f-75

¹⁸ Intervistë, Enver Haxhijaj IKAP, në MAP, 17.01.2019

¹⁹ Raporti për gjendjen në shërbimin civil të Republikës së Kosovës për Vitin 2016, maj 2017, Përbërja e shërbimit civil. f-21.

²⁰ Raporti për gjendjen në shërbimin civil të Republikës së Kosovës për Vitin 2017, maj 2018, Përbërja e shërbimit civil. f-39.

REKOMANDIME

Institucionet bartëse të strategjive duhet të përdorin afatet kohore të përcaktuara në Plan të Veprimit për realizim të aktiviteteve, si udhërrëfyes për implementim të strategjisë duke:

a) Ju dhënë përparësi aktiviteteve me afat më të afërt kohor të zbatimit, pa i lënë anash aktivitetet me afat më të largët; dhe

b) I evidentuar aktivitetet të cilat nuk janë përmbushur apo janë në proces dhe do të përmbushen në vitin apo periudhën kohore vijuese.

Raportimi mbi nivelin e zbatimi të Planeve të Veprimit të strategjive përkatëse duhet të orientohet nga matja e ndikimit të strategjisë, e cila mund të bëhet me anë të indikatorëve specifik dhe të matshëm.

ZPS, SKZH

Duhet të bëj më shumë presion tek institucionet bartëse dhe të linjës për realizim të aktiviteteve dhe raportim mbi zbatimin e tyre.

ZPS, SPI

Duhet të bëj presion te të gjitha ministrinë, që të krijojnë grupe për menaxhim strategjik (GMS), për të pasur efekt në implementim më të lehtë të SPI por edhe të dokumenteve tjera strategjike.

MAP, SMAP

Duhet të shtojë angazhimin në realizimin e aktiviteteve në shtyllën II, pasi kjo është shtylla me progresin më të ulët në Planin e parë të Veprimit;

Duhet të bëhet më shumë presion tek qeveria për alokim të buxhetit të nevojshëm në sistemin e ri të pagave, pasi që mospërfundimi i këtij procesi ka

bllokuar edhe një varg reformash dhe ndryshimesh tjera në administratë publike.

MAP, Strategjia për Trajnim të Nëpunësve Civil

Plani i ri i Veprimit duhet t'i adresojë drejtpërdrejtë nevojat e identifikuara nga strategjia dhe të hartohet një Plan i Veprimit që është më specifik dhe më lehtë i implementueshëm.

Duhet të përcaktohen mekanizma të përzgjedhjes së pjesëmarrësve në programe trajnuese në mënyrë që të ulët numri i nëpunësve që ndjekin programin dy herë dhe të përfshihen në programe trajnuese sa më shumë nëpunës civil ndër vite.

MAPL

Te Strategjia për Vetëqeverisje Lokale duhet të rishikohet Plani i Veprimit, duke e draftuar një të ri me një periudhë më të shkurtër të zbatimit, maksimum tri vite, ashtu siç parashihet edhe me UA 07/2018.

Të përfshihen më shumë autoritetet lokale, komunitat, bizneset, organizatat joqeveritare dhe shoqatat në planifikim të Planit të Veprimit dhe në rishikim të strategjisë, me qëllim që të identifikohen nevojat dhe të lehtësohet implementimi.

Kjo vlen edhe për te MAPL a po? Duhet të bëj më shumë presion tek institucionet bartëse dhe të linjës për realizim të aktiviteteve dhe raportim mbi zbatimin e tyre.



Demokrasi Plus (D+) është organizatë jo qeveritare që bashkon persona që besojnë fuqishëm në vlera demokratike dhe në një Kosovë me demokraci të mirëfilltë. Qëllimi kryesor i D+ është të nxisë vlera dhe praktika demokratike, si dhe politika që stimulojnë aktivizmin qytetarë.

Në kuadër të D+ funksionojnë tri programe kryesore: Programi për Qeverisje të Mirë, Programi për Sundim të Ligjit, dhe Programi për Zgjedhje dhe Parti Politike. D+ punon që të angazhojë institucionet qeveritare, qytetarët dhe mediat në përmirësimin e qeverisjes, avancim të politikave publike dhe fuqizimin e sundimit të ligjit.

Organizata jonë përqendrohet në përdorimin e teknologjisë informative për qëllimet e lartëshënuara, dhe si rezultat ka iniciuar platformat online ndrege.com dhe qeverisjatani.info të cilat ofrojnë hapësirë për pjesëmarrje qytetare në vendimarrje dhe llogaridhënie të institucioneve qeveritare. Për më tepër, D+ është anëtare ProOpen, koalicion i OJQ-ve, që ka për qëllim ngritjen e transparencës në prokurim publik dhe parandalimin e keqpërdorimit të parasë publike.

www.dplus-ks.org

Përkrahur nga:

